



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2024

Lënda : Kthim përgjigje

Drejtuar:

Në përgjigje të kërkesës tuaj, datë 06.02.2024, administruar në Bashkinë Shkodër me nr. 2513 Prot, datë 08.02.2024, me objekt “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit”, ju sqarojmë se:

1. Cila është ndihma që jep Bashkia Shkodër për rastet e dhunës në familje?

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”(i ndryshuar), i ndryshuar me Ligjin Nr.47/2018, neni 8, pika 8 e tij; si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, (i ndryshuar).

Bashkia e Shkodrës ka krijuar dhe vënë në funksion Qendrat Komunitare “Për Familjen”; Aktualisht janë në funksion 12 qendra; 7 në zonën urbane dhe 5 në njësitë administrative. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komunitetit, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, ofrohen shërbime për familjet në vështirësi socio-ekonomike, vulnerabël ndaj fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe gjithashtu janë trajtuar dhe mbështetur viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ofruar shërbime sipas nevojave specifike të secilit rast, me konkretisht:

Shërbime të specializuara:

- Strehëz për rastet emergjente të dhunës me bazë gjinore;
- Staf i posaçëm on-call, i trajnuar për ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e rasteve emergjente, i cili funksionon 24/24, 7 në 7;

- Strehëz rezidenciale;
- Qendër ditore që ofron shërbime me orare të zgjatura dhe në fundjavë, për fëmijët e rasteve të dhunës në familje, VMT apo VT;
- Monitorimi çdo 60 ditë i ekzekutimit të urdhërit të mbrojtjes.;
- Mbështetje psikologjike dhe ligjore nga stafi i Qendrave Komunitare “Për Familjen” të Bashkisë Shkodër dhe organizatat partnere që ofrojnë të tilla shërbime në Bashkinë Shkodër;
- Lehtësira në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër, duke i përjashtuar nga pagesa e çerdheve dhe kopshteve;
- Pagesa nga skema e ndihmës ekonomike;
- Programe këshillimi, konsulence dhe rehabilitimi për dhunuesit;

Shërbime parashoqërore:

- Informim, orientim, këshillim;
- Shërbim në familje;
- Mbështetje psiko - sociale;
- Ndërhyrje e hershme.

Shërbime komunitare:

- Shërbim për fëmijën dhe familjen, fuqizim ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komuniteti;
- Mbrojtja e fëmijëve;
- Shërbime multifunkionale: shërbime arsimore, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, klasa passhkollore;
- Shërbime lëvizëse, transferimi dhe implementimi i shërbimeve komunitare sociale, në lagje dhe njësi administrative të bashkisë së Shkodrës;
- Shërbime për të rinjtë (Qendra Rinore Atelie).
- Hapja e çerdheve, kopshteve dhe qendrave shëndetësore të reja, në shërbim të komunitetit me qëllim krijimin e mundësive për punësim të grave dhe vajzave – nëna.
- Krijimi i apartamenteve sociale (ish konvikti pyjores) me destinacion jetimët që jetojnë në konvikte, jetimët që dalin nga strukturat rezidenciale dhe gratë kryefamiljare në situatë të vështirë socio-ekonomike;

2. A ka një buxhet të specifikuar dhe strukture për të mbështetur viktimat e dhunës në familje?

Bashkia Shkodër ka në përbërjen e saj Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, e cila është drejtori e krijuar për herë të parë në Bashkinë e Shkodrës në fillim të vitit 2016.

Vizioni i kësaj drejtorie është “Shërbime Sociale multisektoriale, të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë”.

Struktura e kësaj drejtorie përbëhet nga 2 sektorë si më poshtë:

1. Sektori i Përfshirjes Sociale, Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Strehimit.
2. Sektori i Planifikimit Strategjik, Standarteve e Monitorimit për Shërbimet sociale dhe Shëndetin Publik, i cili është edhe sektori që mbulon çështjet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale Strehimit dhe Shëndetit Publik pranë Bashkisë Shkodër përbëhet nga 23 persona staf, afërsisht 11 nga këto janë të përfshirë direkt me detyra specifike në çështjet e dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore.

Buxheti në dispozicion të aktiviteteve ndërgjegjësuese në lidhje me dhunën me bazë gjinore, për vitin 2023 është i ndarë në këto zëra:

1. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje (200 mijë lekë);
2. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore (150 mijë lekë);
3. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi (100 mijë lekë).

Fond tjetër në dispozicion për ofrimin e shërbimeve konsiston në kostot për paga dhe sigurime për stafin dhe kosto operative për funksionimin e Qendrave Komunitare “Për Familjen”, të cilat menaxhojnë drejtpërdrejtë rastet e dhunës në familje.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

KRYETAR

Benet Beci